



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 77/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.02.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “COLOMBO” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Ndërtim palestre ”Shkolla e Mesme e Bashkuar Farkë””, me nr. REF-35165-11-21-2017, me fond limit 51,278,786 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.12.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “COLOMBO” sh.p.k.
Adresa: Lagjia “Kryengritja e Fierit”, Rr. “Vangjel Rrushku”, Fier.

Autoriteti kontraktor:

Bashkia Tiranë.
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nd.2, kodi postar 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 22.11.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Ndërtim palestre ”Shkolla e Mesme e Bashkuar Farkë””, me nr. REF-35165-11-21-2017, me fond limit 51,278,786 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.12.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.

II.2 Në datën 19.12.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 27.12.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--------------------------|---------------------------------------|
| 1. ”COLOMBO” sh.p.k. | 37,515,659 lekë pa tvsh Skualifikuar; |
| 2. “Ergi” sh.p.k. | 38,950,468 lekë pa tvsh Skualifikuar; |
| 3. “Arifaj” sh.p.k. | 41,949,896 lekë pa tvsh Kualifikuar; |
| 4. “Kacdedja” sh.p.k. | 42,561,342 lekë pa tvsh Skualifikuar; |
| 5. “KOLA INVEST” sh.p.k. | 42,570,919 lekë pa tvsh Skualifikuar; |

6. "Klajger Konstruksion" & "Varaku-E" sh.p.k	42,988,259 lekë pa tvsh Kualifikuar;
7. "CURRI" sh.p.k.	44,005,089 lekë pa tvsh Skualifikuar;
8. "BE-IS" sh.p.k.	44,905,655 lekë pa tvsh Kualifikuar;
9. "INERTI" sh.p.k.	45,271,692 lekë pa tvsh Skualifikuar;
10. "Bruci" sh.p.k.	45,349,708 lekë pa tvsh Skualifikuar;
11. "S.A.G" & "Viante Konstruksion" sh.p.k.	45,894,255 lekë pa tvsh Skualifikuar;
12. "Pienvi" sh.p.k.	46,461,326 lekë pa tvsh Skualifikuar;
13. "Kronos Konstruksion" & "EVEREST" sh.p.k.	47,179,600 lekë pa tvsh Kualifikuar;
14. "Shansi invest" sh.p.k.	50,664,549 lekë pa tvsh Kualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik "COLOMBO" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyt si më poshtë vijon:

"Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- AK në dokumentat Standarte të Tenderit/Kapaciteti Teknik ka kërkuar për realizimin e kontratës ka kërkuar si më poshtë: Te kete ne staf te punësuar: a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me "Certifikate per auditimin e energjise) 5.3 (Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise. Operatori ekonomik "COLOMBO" shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur si auditues energjie Zj. M.D. për të cilën ka paraqitur një certifikatë ku citohet se ka frekuentuar kurs për auditues energjie por ju bëjmë me dije se autoriteti kontraktor ka kërkuar Certifikatë (DIP) për eficientë në energji. Për sa më sipër operatori ekonomik nuk ka paraqitur 1 punonjës auditues energjie sipas formatit të kërkuar nga AK. Pra sa më sipër shoqëria "COLOMBO" shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

- Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9) Mjetet Sasia Gjendja Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumi 15(pesëmbëdhjetë) ton për secilin kamion 3 copë Pronësi ose me qera MotoGjenerator 1 copë Pronësi ose me qera Eskavator me goma 0.25 m3 2 copë Pronësi ose me qera Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën*

kamionçinë deri në 2 ton 2 copë Pronësi ose me qera Autobetoniere 2 copë Pronësi ose me qera Betonforma 500 m2 Pronësi ose me qera Matrapik 2 cope Pronësi ose me qera Vibrator 2 copë Pronësi ose me qera Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion) 3 cope Pronësi ose me qera Autopompe betoni 1 copë Pronësi ose me qera Depozitë uji (5000) 1 copë Pronësi ose me qera Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë) 1500 m2 Pronësi ose me qera Autobot uji 1 copë Pronësi ose me qera Auto vinç 1 copë Pronësi ose me qera Operatori ekonomik COLOMBO shpk ka paraqitur në shtojcën nr.9 mjetet e mëposhtme: Kamion me targa VL 7082 C me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17.7 T Kamion me targa AA372AY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17.4 T Kamion me targa AA341MK me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 20T Kamion me targa VL2420BK me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7.8 T Kamion me targa VL9735B me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7.7 T Kamion me targa AA883HY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7.9 T Kamion me targa VL1743 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7 T Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vendosen në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 10 ton dhe maximum 15 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë kamion në përmbushje të këtij kriteri pasi kamionat e paraqitur në sistemin elektronik I përkasin tonazhi poshtë 10 Ton dhe mbi 15 ton. Sa më sipër dokumentacioni i shoqërisë lidhur me mjetet me kapacitet mbajtës min 10 ton dhe max 15 ton secili nuk është i saktë , rrjedhimisht i pavlefshëm

Operatori ekonomik COLOMBO ka deklaruar në shtojcën eskavator copë 2 në pronësi me fatura me nr. 1179 dt 10.02.2005 dhe me faturë me nr.11617 dt 23.11.2006 . Për eskavatorët shoqëria ka paraqitur dhe respektivisht për eskavatorin BENNAC 3.12 viti 93 është paraqitur akti i zhdoganimit me nr serie 1179 si dhe eskavatorët shoqëria ka paraqitur dhe respektivisht për eskavatorin FAI 900 C viti 83 është paraqitur akti i zhdoganimit me nr serie 11617, këto mjete nuk janë të targuar dhe për rrjedhim nuk janë të paisur me dokumentacionin përkatës.AK, Bashkia Tirnë ka kërkuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi paraqitjen e një eskavatori me goma. Për eskavatorët me goma shoqëria nuk ka paraqitur lejë qarkullim, çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit, C'ka bie në kundërshtim me "Kriteret e veçanta për kualifikim", kapaciteti Teknik pika 12, gërma (a) ku citohet: Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi Pra sa më sipër cituar eskavatorët me goma nuk kanë lejën e qarkullimit, Çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracion mjeti. Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori

Ekonomik lidhur me shtojcën 9 , është i paplotë ne lidhje me eskavatorin me goma, për rrjedhojë i pavlefshëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit”

II.4. Në datën 03.01.2018 operatori ekonomik ankimues “COLOMBO” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]1. ”Operatori ekonomik COLOMBO SHPK ne permbushje te te kriterit te mesiper m ka paraqitur auditues energjie Zj.M.D. per te cilen ka paraqitur certifikate ku citohet se ka frekuentuar kurs per auditues energjie por ju bejme me dije se autori eti kontraktor ka kerkuar Certifikate (DIP) per eficencen ne energji. Per sa me siper operatori ekonomik nuk ka paraqitur 1 punonjes auditues energjie sipas formatit te kerkaur nga AK. Pra sa me siper shoqeria ”COLOMBO” shpk nuk zoteron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapacitet teknik dhe profesional, cka bie ne kundërshtim me piken 1 germa (a) dhe (b) te nenit 46 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 ”Per prokurimin Publik” i ndryshuar ”.

Referuar pretendimeve te ngritura nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave ,Ju sqarojme sa me poshte:

Shoqeria COLOMBO SHPK ka plotesuar ne menyre korrekte kerkesen tuaj duke paraqitur Kontraten per Ing.elektirik M. D. shoqeruar me dokumentacionin e kerkuar ne DST ,Kontrate Pune ,Certifikata per auditimin e sistemeve te energjise te leshuara nga Institucione te njohura dhe te akredituara ne shqiperi.Certifikata e leshuar nga AQSCERT ,ne te cilen shprehet qarte se Ing.elektrike M. D. (S.) eshte trajnuar prane ketij institucioni ku ka kaluar me suksese provimin dhe ne perfundim te trajnimit i eshte leshuar certifikate Audituese Energjie me date 02.05.2016 siaps standartit nderkombetar ISO 2001:2015. Kete certifikate e kane perfituar te gjitha kompanit te cilat kane prezantuar inxhinieret elektirik per te marr certifikaten e audituesit te energjise. Pretendimi juaj nuk qendron dhe nese ju do te kishit ndonje paqartesi me kete certifikate ,ne baze te ligjit do ti drejtoheshit per informacion ketij institucioni e theksojme te akreditaur dhe licencuar per leshimin e ketyre certifikatave. Pra sa me siper shoqeria jone e konsideron te plotesaur kete kerkese dhe nuk eshte dakort me skualifikimin.

2”Autoriteti kontraktor ka kerkaur ti vendosen ne dispozicion tre kamiona veteshkarkues kapaciteti mbajtes duhet te jete minimumi 10 ton dhe maximumi 15 ton secili kamion per ekzekutimin e kontrates. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje kamion ne permbushje te ketij kriteri pasi kamionat e paraqitur ne sistemin elektronik i perkasin tonazhi poshte 10

ton dhe mbi 15 ton. Sa me siper dokumentacioni i shoqerise lidhur me mjetet me kapacitetet mbajtes min 10 ton dhe max 15 ton secili nuk eshte i sakte, rrjedhimisht i pavlefshem”.

Referuar pretendimeve te ngritura nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave , Ju sqarojme se Tonazhet e kerkuara dhe te pretenduara nga ana Juaj jane te plotesuara ne menyre korrekte nga ana jone pavaresishte se kerkesa juaj eshte diskriminuese dhe jo ligjore, duke vendosur si kriteret tonazhe te ndermjeteme per te ngateruar Operatoret ekonomik ,pasi nuk mund te kerkohen mjete te specifikuar me tonzhe ,referuar librezes se automjetit. Nese do ti referoheni po kesaj librezes te automjeteve ne qarkullim tonazhet duhet te percaktoheshin qarte dhe te sakte siaps saj ,dhe jo apriori. Klasifikimi i mjeteve sipas tonazhit referuar librezave eshte deri ne 3.5 ton, 3.5 -7.5 ton, 7.5-18 ton ,mbi 18 ton. Duke ju referuar lejes se qarkullimit te mjeteve ateher AK duhet te kerkonte standart tonazhin mbajtes dhe duke i krahasuar keto me kerkesat tuaja rezulton se vleresimi i tonazhit duhet referuar klasifikimit te mesiperm te mjeteve te transportit. Ne baze te Kodit Rrugor, SGS-se ,shteti per te vjele taksat ne menyre korrekte e ligjore i referohet klasifikimit te mesiperm te ketyre mjeteve. Tonazhi i kerkuar nga ana juaj eshte plotesaur nga mjetet e paraqitur nga ana jone. Theksojme se per te realizuar kete objekte ,referuar analizave te cmimeve te manualit,kerkesat tuaja nuk jane korrekte dhe ligjore pasi nga zberthimi qe kemi bere ne baze te analizave te cmimit rezulton se duhen jo me shume se dy kamiona dhe se mjetet e paraqitura nga shoqeria jone jane mese te mjaftueshme per realizimin e kesaj kontrate,pasi ju kemi vendosur ne dispozicion 10 automjete transporti te cilat perfshijne te gjitha tonazhet e kerkuara nga ana juaj.Kerkesa jone konsiderohet nga ana jone e plotesuar dhe kerkojme rishikimin dhe kualifikimin e saj.

3-”Per eskavoret me goma shoqeria nuk ka paraqitur leje qarkullimi,certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, C’ka bie ne kundersiztim me ’Kriteret e vecanta per kualifikim” ,kapaciteti teknik pika 12, germa a ku citohet: Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjitha periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes”.

Referuar pretendimitt te ngritur nga Komisioni ti Vleresimit te Ofertave ,ne lidhje me kete sqarojme se:

Ne dokumentata standarte te tenderit jane kerkuar Eskavator me goma 0.25m3 ,cope 2, shoqeria jone ka vendosur ne dispozicion dokumetacionin te sakte per dy eskavator me goma te paraqitura ne sistem me fatura importi zhdoganimi,si dhe kontraten e qeras Nr.1515 Rep ,Nr.1007 Kol duke plotesuar kerkesen sipas DST. Eskavoret e paraqitur me fatur eskavatori tipi BENNAC 3.12 viti 93 , eshte eskavator me goma vetelevizes mbi makine ,eshte makineri e rende dhe nuk futet ne mjete qe shenohen ne regjisrtat publik. Pavaresishte se jane me goma ,per keto mjete nuk lejohet levizja e tyre ne rruge nacionale por vetem brenda perberenda objektit. Zhvendosja e tyre behet me rimorkiator ,si te till nuk

mund te pajisen me targa ,leje qarkullimi apo certificate kolaudimi. Por sipas pikes 12 ,germa (a) jane paraqitur faturat e blerjes si dhe akt zhdoganimet e tyre. Si perfundim kete pike e kosiderojme te permbushur. [...]”

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 100/2 Prot. datë 05.01.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ”COLOMBO” sh.p.k., duke mos pranuar asnjë prej pretendimeve të ngritura prej tij.

II.6.Në datën 12.01.2018 operatori ekonomik ankimues ”COLOMBO” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.7.Në datën 19.01.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2262/1prot., datë 18.01.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “COLOMBO” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : *“Ju sqarojme se Tonazhet e kerkuara dhe te pretenduara nga ana Juaj jane te plotesuara ne menyre korrekte nga ana jone pavaresishte se kerkesa juaj eshte diskriminuese dhe jo ligjore, duke vendosur si kriteretone tonazhet te ndermjeteme per te ngateruar Operatoret ekonomik ,pasi nuk mund te kerkohen mjete te specifikuar me tonazhet ,referuar librezes se automjetit. Nese do ti referoheni po kesaj librezes te automjeteve ne qarkullim tonazhet duhet te percaktoheshin qarte dhe te sakte siaps saj ,dhe jo apriori. Klasifikimi i mjeteve sipas tonazhit referuar librezave eshte deri ne 3.5 ton, 3.5 -7.5 ton, 7.5-18 ton ,mbi 18 ton. Duke ju referuar lejes se qarkullimit te mjeteve ateher AK duhet te kerkonte standart tonazhin mbajtes dhe duke i krahasuar keto me kerkesat tuaja rezulton se vleresimi i tonazhit duhet referuar klasifikimit te mesiperm te mjeteve te transportit. Ne baze te Kodit Rrugor, SGS-se ,shteti per te vjele taksat ne menyre korrekte e ligjore i referohet klasifikimit te mesiperm te ketyre mjeteve. Tonazhi i kerkuar nga ana juaj eshte plotesaur nga mjetet e paraqitur nga ana jone. Theksojme se per te realizuar kete objekte ,referuar analizave te cmimeve te manualit,kerkesat tuaja nuk jane korrekte dhe ligjore pasi nga zberthimi qe kemi bere ne baze te analizave te cmimit rezulton se duhen jo me shume se dy kamiona dhe se mjetet e paraqitura nga shoqeria jone jane mese te mjaftueshme per realizimin e kesaj kontrate,pasi*

ju kemi vendosur ne dispozicion 10 automjete transporti te cilat perfshijne te gjitha tonazhet e kerkuara nga ana juaj. Kerkesa jone konsiderohet nga ana jone e plotesuar dhe kerkojme rishikimin dhe kualifikimin e saj. ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 12 të shtojcës 10, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“12. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

-Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumi 15(pesëmbdhjetë) ton për secilin kamion, 3 copë, Pronësi ose me qera;

-MotoGjenerator, 1 copë, Pronësi ose me qera;

-Eskavator me goma 0.25 m3, 2 copë, Pronësi ose me qera;

-Kamioçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamioçinë deri në 2 ton, 2 copë, Pronësi ose me qera;

-Autobetoniere, 2 copë, Pronësi ose me qera;

-Betonforma, 500 m2, Pronësi ose me qera;

-Matrapik, 2 cope, Pronësi ose me qera;

-Vibrator, 2 copë, Pronësi ose me qera;

-Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pike pese) ton dhe maksimumi 5 (pese) ton per secilin kamion), 3 cope, Pronësi ose me qera;

-Autopompe betoni ,1 copë, Pronësi ose me qera;

-Depozitë uji (5000,) 1 copë, Pronësi ose me qera;

-Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë), 1500 m2, Pronësi ose me qera;

-Autobot uji, 1 copë, Pronësi ose me qera;

-Auto vinç, 1copë, Pronësi ose me qera;

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 30 copë

- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë

- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë

- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë

- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi). ”

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues, “COLOMBO” sh.p.k, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë Qiraje nr.1365rep, nr.767/1kol, datë 19.04.2016, me qiramarrës ”COLOMBO” sh.p.k , objekt i kësaj kontrate, ndër të tjera, është dhënia me qira e Kamionëve me targë VL7082C; VL2420B; VL9735B dhe Kamioncinave me targë VL1119C; AA416KL; VL9884A; AA381CR, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
2. Kontratë Qiraje nr.4418rep, nr.3049/1kol, datë 18.12.2017, me qiramarrës ”COLOMBO” sh.p.k , objekt i kësaj kontrate, ndër të tjera, është dhënia me qira e Kamionëve me targë VL1743C; AA883HY; dhe Kamioncinave me targë AA760JN; VL8646B, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
3. Kontratë Qiraje nr.3007rep, nr.1721/2kol, datë 15.08.2016, me qiramarrës ”COLOMBO” sh.p.k , objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e Kamionit me targë AA341MK, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
4. Kontratë Qiraje nr.2017rep, nr.627kol, datë 08.07.2015, me qiramarrës ”COLOMBO” sh.p.k , objekt i kësaj kontrate, ndër të tjera, është dhënia me qira e Kamionit me targë AA372AY, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se:

“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose 6

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.5. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, përkatësisht shtojcën 9 “Mbi disponimin e makinerive e pajisjeve”, me anë të së cilës operatori ekonomik ankimes deklaroi se zotëron mjetet dhe pajisjet teknike për të realizuar kontratën objekt prokurimi, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për kamionat dhe kamioncinat, referuar dokumentit leje e qarkullimit të mjetit, në të cilin konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat e mjetit, ndërmjet të cilave edhe kapaciteti mbajtës i tij, në nr. Rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg), evidentohet si më poshtë:

- Për mjetin me targë VL1119C, kapaciteti mbajtës = 4.39 ton (më pak se 10 ton).
- Për mjetin me targë VL7082C, kapaciteti mbajtës = 17.65 ton (më shumë se 15 ton).
- Për mjetin me targë AA760JN, kapaciteti mbajtës = 3.98 ton (më pak se 10 ton).
- Për mjetin me targë VL1743C, kapaciteti mbajtës = 7 ton (më pak se 10 ton).
- Për mjetin me targë AA416KL, kapaciteti mbajtës = 1.46 ton (më pak se 10 ton).
- Për mjetin me targë AA341MK, kapaciteti mbajtës = 20 ton (më shumë se 15 ton).
- Për mjetin me targë VL9884A, kapaciteti mbajtës = 1.59 ton (më pak se 10 ton).
- Për mjetin me targë AA883HY, kapaciteti mbajtës = 2.93 ton (më pak se 10 ton).
- Për mjetin me targë VL8646B, kapaciteti mbajtës = 3.56 ton (më pak se 10 ton).
- Për mjetin me targë AA372AY, kapaciteti mbajtës = 17.45 ton (më shumë se 15 ton).
- Për mjetin me targë AA381CR, kapaciteti mbajtës = 1.1 ton (më pak se 10 ton).
- Për mjetin me targë VL2420B, kapaciteti mbajtës = 7.8 ton (më pak se 10 ton).
- Për mjetin me targë VL9735B, kapaciteti mbajtës = 7.7 ton (më pak se 10 ton).

III.1.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e 3 mjeteve me kapacitet mbajtës 10-15 ton. Konstatohet se, asnjë nga mjetet e deklaruara nga operatori ekonomik si kamion apo kamioncinë në shtojcën 9, për të cilët ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të dokumentave të tenderit, plotëson këtë kapacitet përse i përket kapacitetit mbajtës së parashikuar nga autoriteti në DST. Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi, referuar mangësive dhe pasaktësirave të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të plotësohet tonazhi i kërkuar i mjeteve, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 12 të shtojcës 10, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, ndërkohë që asnjë nga mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues i përmbushë kushtet e kriterit, përse i takon disponimit të 3 mjeteve me kapacitet mbajtës 10-15 ton.

III.1.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.9. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “COLOMBO” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “COLOMBO” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Ndërtim palestre ”Shkolla e Mesme e Bashkuar Farkë”*”, me nr. REF-35165-11-21-2017, me fond limit 51,278,786 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.12.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 50 protokoli Datë 12.01.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

